



Mirë se vini!

Informacion për prindërit



Të dashur prindër,

me këtë broshurë, ne dëshirojmë të mbështesim ardhjen Tuaj në vendin tonë dhe t'ju japim një pasqyrë të parë në sistemin tonë të kujdesit ditor të fëmijëve. Çdo fëmijë duhet ti ketë të njëjtat mundësi për edukim të mirë. Për këtë arsye, ne kemi vendosur si qëllim përmirësimin e mundësive arsimore për të gjithë fëmijët në Nordrhein-Westfalen. Një kontribut të rëndësishëm për këtë ofron puna e arsimit të hershëm pedagogjik në një qendër të kujdesit ditor ose një çerdheje. Qendra e kujdesit ditor, e quajtur edhe "Kita", është institucioni i parë arsimor në Nordrhein-Westfalen dhe frekuentohet krahas çerdhes nga shumë fëmijë në moshën më të re se tre vjeç. Nga moshë tre vjeçare, pothuajse të gjithë fëmijët kanë një vend në Kita

Kita është një shërbim përkujdesjeje në të cilën fëmijëve ju ipet mbështetje dhe përkrahje në të njëjtën kohë. Sidomos në kohën e fillimit pasi keni mbërritur, Kita mund ta ndihmojë fëmijën tuaj të njohë mjedisin e ri, të bëjë miq dhe të mësojë gjuhën gjermane. Mësimi i gjuhës gjermane është gjithashtu një përgatitje e rëndësishme për frekuentimin e mëvonshme të shkollës.

Të bindur se profesionistët arsimor në Kitat të Nordrhein-Westfalen mund ta indikojnë fëmijën tuaj pozitivisht në jetën e tij dhe në zhvillimin e tij, do të isha i gëzuar nëse e pranoni këtë ofertë të vlefshme edukimi dhe kujdesi dhe do të regjistroni fëmijën Tuaj.

I Juaji

Joachim Stamp

Dr. Joachim Stamp

Minister für Kinder, Familie, Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen



Qendra e Kujdesit Ditor (Kita)

- Në kopsht fëmijëve do t'u ofrohet kujdestari në grupe në ambientet e veçanta të përgatitura për ta.
- Shumë edukatorë do të kujdesen për fëmijën tuaj, në mënyrë që ai të luaj i qetë me fëmijët e tjerë, të qeshë, të kërcëjë, të këndojë dhe të bëjë punë dore.
- Edukatorët me njohuritë e tyre profesionale kontribuojnë me mbështetjen më të mirë në procesin e formimit dhe të zhvillimit të fëmijës tuaj.
- Oraret e kujdestarisë të institucionit ndryshojnë. Shumë kopshte janë të hapura nga mëngjesi deri në pasditen e vonë dhe do të ketë një marrëveshje me ju për orarin e sjelljes dhe marrjes së fëmijës.
- Te kujdestaria përfshihen edhe vaktet e përbashkëta brenda kohës së kujdestarisë, kryesisht një vakt mëngjesi, një drekë dhe një vakt i vogël pasdite.
- Në kopsht do të organizohen shumë aktivitete të përbashkëta, por është veçanërisht e rëndësishme, që ato të përshtaten me nevojat dhe interesat individuale të fëmijës tuaj.
- Bashkëpunimi mes jush dhe edukatorëve ka një rëndësi tepër të madhe.

Regjistrimi në Qendrën e Kujdesit Ditor

- Fëmijët që pasi të mbushin një vjeç kanë të drejtën për një vend në çerdhe. Për fëmijët një dhe dy vjeç ky mund të jetë edhe një vend në qendrën e kujdesit ditor.
- Qendra Rinore në vend ju ofron këshillim dhe ju mbështet në kërkimin e një vendi për fëmijën tuaj.
- Nëse e keni regjistruar fëmijën tuaj dhe keni siguruar një vend, në intervistën e pranimit mund të shkëmbeni informacionet e para.
- Për frekuentimin e kopshtit normalisht llogaritet një kontribut nga prindërit. Shuma e të ardhurave tuaja përcakton nëse do të paguani dhe sa do të jetë kontributi që do të paguani. Viti i fundit para shkollimit është pa pagesë për të gjithë fëmijët në Nordrhein-Westfalen.
- Pas regjistrimit në këtë institucion vijon faza e përshtatjes.
- Fëmijët zakonisht kanë nevojë për më shumë kohë, për t'u përshtatur me ecurinë, mjedisin e ri dhe me fytyrat e reja.
- Në këtë kohë edukatorët bien dakord me ju, me qëllim që fëmija juaj të përshtatet si duhet dhe të ndihet mirë.

Oferta e Qendrës së Kujdesit Ditor

- Në radhë të parë fëmija juaj në kopsht mund të luajë, të pikturojë, të krijojë, të këndojë dhe të bëjë shumë gjëra të tjera.
- Fëmija juaj njihet me fëmijë të tjerë dhe krijon miqësitë e para. Në raportet ditore krijon kontakt me gjuhën gjermane, gjë që është tepër e rëndësishme për mundësitë arsimimit në Gjermani.
- Oferimi pedagogjik është shumë i larmishëm dhe mbështet procesin mësimor të fëmijës tuaj.
- Edukatorët e shoqërojnë fëmijën tuaj, respektojnë nevojat individuale dhe kujdesen që fëmija juaj të ndihet mirë, të shpalosë veten dhe të shfrytëzojë sa më mirë potencialin e tij.

Roli i prindërve


- Bashkëpunimi i edukatorëve me prindërit është shumë i rëndësishëm.
- Prindërit u japin edukatorëve informacione të rëndësishme për fëmijën e tyre, si për shembull rreth problemeve shëndetësore, alergjitë apo ngjarje të rëndësishme, që e angazhojnë fëmijën tuaj.
- Me edukatorët mund të flisni edhe për shqetësimet tuaja, frikën dhe problemet në lidhje me frekuentimin e kopshtit apo të jepni informacion për situatën e jetesës familjare.
- Informacionet i ndihmojnë edukatorët, të orientohen sa më mirë me nevojat e fëmijës tuaj.
- Është vendimi juaj, se cilat informacione duhet të marrin më shumë vëmendje dhe për çfarë duhet të flisni me edukatorët. Informacionet tuaja do të jenë konfidenciale në kopsht.
- Në kopsht edhe prindërit vetë mund të njohin prindër të tjerë, të marrin vetë pjesë në shumë aktivitete dhe të këshillohen e të shkëmbejnë informacione me stafin pedagogjik.
- Kopshti do të përpiqet t'ju ofrojë një përkthyes, për të përkthyer bisedën, nëse do të jetë e domosdoshme.


Si të gjej një kopsht?


- Në ambientin e çdo vendbanimi ka një qendër të kujdesit ditor. Pyesni në Qendrën Rinore, që është përgjegjëse për vendbanimin tuaj.
- Mund të kërkoni një kopsht për fëmijën të www.kita.nrw.de ose direkt në faqen e internetit www.kita.nrw.de/eltern/kita-finder/kita-finder-nrw.


Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen

Haroldstraße 4, 40213 Düsseldorf
Telefon: 0211 837-02
poststelle@mkffi.nrw.de
www.chancen.nrw

 @ChancenNRW

 @ChancenNRW

 Chancen_nrw

 Chancen NRW

